

V E N D I M
Nr.445, datë 16.7.1998

**PËR NGRITJEN E ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Në zbatim të nenit 4 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe ekipit përzgjedhës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Emërimin e Komisionit Kombëtar Rregullator të përbërë nga:

1. Vladimir Meksi	kryetar	me mandat 5 vjet
2. Marjana Çoku	anëtare	me mandat 4 vjet
3. Ana Metohu	anëtare	me mandat 3 vjet
4. Vilma Bibolli	anëtare	me mandat 2 vjet
5. Jeta Manoku	anëtare	me mandat 1 vit .

2. Paga e Kryetarit të Komisionit Kombëtar Rregullator të njehsohet me pagën e Zëvendësministrit, sipas pikës 3 të lidhjes II/5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.213, datë 23.3.1998 "Për rritjen e pagave të funksionarëve të lartë shtetërorë", paga e anëtarëve të komisionit të njehsohet me pagën e Drejtorit të Përgjithshëm në ministri, sipas pikës 6 të lidhjes II/5 të po këtij vendimi dhe paga e specialistit të njehsohet me pagën e specialistit në ministri.

3. Entit rregullator për vitin 1998, i akordohet një fond prej 3 milionë lekësh, që përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave i parashikuar për vitin 1998.

4. Selia e Entit Rregullator do të jetë në Tiranë, pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano